

Pyetësor

1. Cili nga çiftet e lëndëve të mëposhtme përdoren më shpesh te reaktorët bërthamorë?
 - Uraniumi dhe plutoniumi
 - Karboni dhe oksigjeni
 - Neoni dhe litiumi
 - Bori dhe hidrogjeni
2. Çfarë është fisioni bërthamor?
 - Një proces nëpërmjet të cilit yjet prodhojnë dritë dhe energji termike
 - Ndarja e bërthamës së atomeve duke krijuar dy bërthama më të vogla
 - Bashkim i dy atomeve për të krijuar një atom më të rëndë
 - Procesi nëpërmjet të cilit elektronet largohen nga një element
3. Çfarë përthith një bërthamë që të ndodhë fisioni?
 - Proton
 - Neutron
 - Elektron
 - Energji
4. Çfarë ndodh me atomin, pasi ai përthith një neutron?
 - Atomi bëhet i paqëndrueshëm dhe zbërthehet në dy atome më të vogla dhe çliron më shumë neutrone dhe energji.
 - Largon elektrone.
 - Largon protone.
 - Neutroni del sërish jashtë pa ndodhur asgjë.
5. Çfarë ndodh me neutronet e çliruara?
 - Zbërthehen në protone dhe elektrone.
 - Zbërthehen në elektrone.
 - Përthithen nga atomet të tjera duke ndarë më shumë atome në atome më të vogla.
 - Bashkohen me pjesën tjetër të neutroneve për të krijuar një masë të madhe neutronesh.
6. Në një central bërthamor ndodh një reaksion zinxhir. Çfarë është një reaksion zinxhir?
 - Reaksione, ku një reaksion shkakton një sërë reaksionesh, të cilat shkaktojnë një sërë reaksionesh të tjera dhe kështu me radhë.
 - Reaksione, ku ndodh reaksioni i parë dhe të tjerët pengohen.
 - Reaksione, ku një numër i përcaktuar reaksionesh ndodh dhe pjesa tjetër jo.
 - Reaksione, që nuk ndalojnë kurrë.
7. Në një reaktor bërthamor, uji përdoret si rregullator. Çfarë është një rregullator?

- Një lëndë, e cila rrit shpejtësinë e reaksionit bërthamor.
 - Një lëndë, e cila ngadalëson neutronet në procesin e misionit.
 - Një lëndë, e cila ngadalëson prodhimin e elektricitetit.
 - Një lëndë, që përthith neutronet e tepërta.
8. Nëse uraniami-235 dhe një neutron janë goditur me njëri-tjetrin dhe kështu është krijuar një Kr^{92} dhe një Ba^{142} . Në këto kushte, sa neutrone të lira janë çliruar në këtë reaksion?
- 1
 - 2
 - 3
 - 4
9. Cila nga pikat e mëposhtme është një përparësi e fisionit bërthamor?
- Ai prodhon lëndë radioaktive.
 - Një përqindje e vogël energjie merret në dalje në lidhje me atë në hyrje të procesit.
 - Duhet një sasi e madhe e lëndës përkatëse për të realizuar këtë proces.
 - Duhet një sasi e vogël e lëndës përkatëse për të realizuar këtë proces.
10. Cila nga pikat e mëposhtme është një përparësi e fisionit bërthamor?
- Ka mbetje të mëdha lëndësh radioaktive.
 - Duhet një sasi e madhe e lëndës përkatëse për të realizuar këtë proces.
 - Prodhon sasi të madhe energjie.
 - Reaktorët bërthamorë janë të lirë për të ndërtuar.

Pyetjet	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigjet e sakta	1	2	2	1	3	1	2	1	1	4